

VENDIM
Nr.838, datë 5.12.2007

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 6 të vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Pozicionet “Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit” dhe “Drejtor i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj” në Kryeministri, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 8 000 (tetë mijë) lekësh, në muaj, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Pozicionet “Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit” dhe “Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj”, në Kryeministri, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh në muaj, mbi pagën bazë mujore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha